



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 52, dt. 11.03.2016

Në mbështetje të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 11.03.2016, pasi shqyrtoi projektin e diskutuar më parë dhe në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës, lidhur me projektin “Rimodelim i hyrjes së Ministrisë së Integritimit Evropian”,

VENDOSI:

1. Të miratojë projektin për ndërtimin e rampës në funksion të Personave me Aftësi të Kufizuar, në hyrjen e Ministrisë së Integritimit Evropian.
 2. Të mos miratojë strehën dhe parrmakët metalikë të shkallëve në hyrje të godinës, të propozuara në këtë projekt.
 3. Lidhur me strehën e hyrjes së Ministrisë së Integritimit Evropian, të propozohet një variant i ri strehe me materiale reversibël.
 4. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
 5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI

SEKRETAR I KKR

ARTA DOLLANI